

Dalës-Izleзна

Nr. 1-160
Br.

Data 12-09-2019
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 61 të Statutit të Komunës së Obiliqit, caktoj:

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me dt. 18.09.2019, (e mërkurë) në ora 10:00 në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draf Buxhetit për vitin 2020 dhe parashikimi për vitet 2021-2022
4. Shqyrtimi i kërkesave
5. Të ndryshme



Kryesuesi i Komitetit

Burim Gërguri
Burim Gërguri



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E OBILIQI-OPSTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Dalës-izlazno

Nr. -1-159

Data 12.09.2019

Br.

Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.27.08.2019, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm janë këta anëtarë: Burim Gërguri, Florije Jashari, Qendresa Dubova, Fatmir Bekteshi, Hysni Mjeku dhe Slavisa Spasic

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiqi, Nënkyetar i Komunës, Lendita Bekteshi, drejtoreshë e DAP, Naim Miftari, drejtor i DSHPE-së, Arben Berisha, drejtor i DPUKP-së, Zarife Behluli, drejtoreshë e DEFZH, Vlora Mjekiqi Kabashi, drejtoreshë e DSHMS-së, Ilire Kelmendi Shema, drejtoreshë e DKRS-së, Fatime Pllana, udhëheqëse e sektorit për Arsim, përf. e KFOR-it dhe përf. i IZHL-së.

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores Për Ndarjen e Bursave , Kompensimin e Shpenzimeve të Udhëtimit dhe Aktiviteteve Jashtëshkollore .
4. Shqyrtimi i Draft-Planit Strategjik Parësor Shëndetësor për Komunën e Obiliqit
5. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së, për dhënin në diskutim publik të Draft Rregullorës për Administrimin e Shtëpive të Kulturës në Komunën e Obiliqit
6. Shqyrtimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës, për shpallje me interes të përgjithëshëm publik për parcelat kadastrale në zonën kadastrale në Caravodicë
7. Shqyrtimi i Propozim Vendimeve të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunal në shfrytëzim afatgjatë në Llazarevë :
 - a. Investitori : Kolegji BIZNESI ,Prishtinë .
 - b. Investitori :APOLLONIA ,SH.P.K
8. Shqyrtimi i kërkesës së MAPL-së (rishikimi i vendimit nr I-106, të dt.28.06.2019)
9. Shqyrtimi i kërkesave
10. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u aprovua njëzërit nga të pranishmit,

Pika 1 e rendit të ditës

Mungoi: Qendresa Dubova me leje

Pika 2 e rendit të ditës

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota “Për” e aprovuan ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesi - Fjalën ia dha udhëheqëses së sektorit për Arsim për paraqitjen e ndryshimeve në Draft Rregulloren për ndarjen e bursave, kompenzimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore.

Fatime Pllana – Paraqiti ndryshimet e Draft Rregullores në fjalë dhe atë:

-Neni 5, Komisionin për ndarjen e bursave, kompenzimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore e formon Kryetari i Komunës, kurse Komisionin për ankesa e formon Kuvendi i Komunës, për çdo vit shkollor përkatësisht akademik. Komisionet do të jenë të përziera, nga anëtarët e Kuvendit dhe nga administrata.

Neni 15, Komuna e Obiliqit varësisht prej mjeteve në dispozicion ndan shpërblime për nxënës nga Komuna e Obiliqit, të cilët do të jenë fitues në gara në nivel Komune dhe republike për 3 vendet e para. Komuna e Obiliqit varësisht prej mjeteve në dispozicion ndan shpërblime për mësimdhënës apo udhëheqësin e ekipit garues të nxënësve sipas lëndëve, apo lëmive përkatëse për të cilat nxënësit janë radhitur në 3 vendet e para.

Neni 16, Kryetari i Komunës, merrë vendim për ndarjen e shpërblimeve dhe lartësinë e shpërblimit për secilin vend sipas nenit 15, për nivelin komunal dhe republikan për nxënës dhe ndaras për mësimdhënës.

Neni 17, Shpërblimet ndahen pa përfunduar viti kalendarik përkatësisht në të cilat janë mbajtur garat dhe janë nxënë 3 vendet e para.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota “Për” morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-Rregullores Për Ndarjen e Bursave, Kompensimin e Shpenzimeve të Udhëtimit dhe Aktiviteteve Jashtëshkollore.

Pika 4 e rendit të ditës

Ibush Mjekiqi – Në kohën kur është marrë vendimi për formimin e Komisionit për hartimin e këtij koncept dokumenti për strategjinë për kujdesin parësor shëndetësor, unë kam qenë drejtor i shëndetësisë dhe ky dokument është në përfundim e sipër. Është punuar një dokument i cili do të jetë mjaft përmbajtësor dhe voluminoz, që i ka kaluar të gjitha procedurat dhe ne kërkojmë që të rekomandohet në Kuvend për aprovim.

Kryesuesi – Pyeti se a është inkorporuar edhe Ligji për Obiliqin dhe a kemi mund të bëjmë diçka me Ministrinë e shëndetësisë që me zvoglue numrin e banorëve në kuptimin se është e rregulluar me ligj për shërbime ndaj qytetarëve.

Ibush Mjekiqi – Përgjegjet se kjo e parashehë zhvillimin ose organizimin e kujdesit primar shëndetësor në nivelin komunal në 5 vitet e ardhshme, duke u bazuar në ligjet në fuqi dhe Ligji për Obiliqin, është marrë parasysh në këtë dokument.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota “Për” morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-Planit Strategjik Parësor Shëndetësor për Komunën e Obiliqit.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesi - Për një sqarim më të gjerë të dokumentit bazik për administrimin e të gjitha Shtëpive të kulturës, në Komunën e Obiliqit, fjalën ia dha drejtoreshës së DKRS-së.

Ilire Kelmendi Shema – Ne si Drejtori e kulturës, për arsye të disa problemeve me fusha sportive kemi menduar ti bëjmë 2 Draft Rregullore bazë, një për pjesën e sportit dhe një për pjesën e trashëgimisë dhe kulturës. Për këtë arsye kemi vendosë që të gjitha objektet kulturore ti përfshijmë në një Draft Rregullore.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota “Për” morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së DKRS-së, për dhënien në diskutim publik të Draft Rregullorës për Administrimin e Shtëpive të Kulturës në Komunën e Obiliqit.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti Propozim Vendimin nga Kryetari i Komunës, për shpallje me interes të përgjithshëm publik për parcelat kadastrale në zonën kadastrale në Caravodicë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota "Për" morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës, për shpallje me interes të përgjithshëm publik për parcelat kadastrale në zonën kadastrale në Caravodicë.

Pika e 7 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti Propozim Vendimet e Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë në Llazarevë për Investitorin "Kolegji BIZNESI" Prishtinë dhe Investitorin APOLLONIA SH.P.K.

Fatmir Bekteshi – Edhe unë kam qenë atë ditë, kur ky e ka prezentue këtë plan, por unë e kisha vendosë edhe një kusht sepse ky na krahasoi neve, se ne po ia japim pronën në shfrytëzim për 99 vite dhe neve na vlerësoi si Vushtria psh atje ka objektin me qira. Pra, pse mos me i pasë ne më shumë bursa, por vetëm 5, kështu që e kisha futë edhe këtë kusht te anëtarët e Komisionit, që me rritë pak numrin.

Kryesuesi – Besoj se përmes kontratës do të trajtohet kjo çështje dhe ne mund ta negocijojmë çështjen e bursave, por në vendim nuk mund ta përfshijmë.

Arben Berisha – Sipas Ligjt të ri për dhënien në shfrytëzim, tash të negocijimit direkt nuk ka mundësi të kushtëzimit sepse është çështje e zhvillimit të biznesit. Negocijimi direkt i Kryetarit, është se ai ka dashtë me qenë transparentë dhe me i ftue grupet parlamentare sepse e ka të drejtën ligjore sipas ligjit të ri, të negocijimi direkt mbi vlerën e caktuar që është vlera buxhetore e vitit të kaluar.

Kryesuesi – Mua, më duket se është një investitor bukur serioz në raport me të tjerët, është arsim, edukim që ne kemi nevojë në këtë drejtim. Propozimi i projektit më është dukë interesantë dhe kërkesa për pronë që ishte nuk ka qenë kërkesë e madhe me numrin e të punësuarve që e ka.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 5 vota "Për" morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimeve të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë në Llazarevë:

- a) Investitori : "Kolegji BIZNESI" Prishtinë
- b) Investitori : APOLLONIA SH.P.K

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga MAPL-ja, për rishikimin e vendimit nr.I-106, të dt.28.06.2019, fjala është për Rregulloren për subvencionimin e energjisë elektrike.

Naim Miftari – Rregullorja është kthyer nga MAPL-ja, për rishikim, por asnjë nen i Rregullores nuk potencohet se është në kundërshtim me Ligjin për Obiliqin. Unë kam kërkuar nga MAPL-ja, një interpretim ligjor, ndërsa MAPL-ja, kërkesën time e ka dërguar në Ministri të financave, që shpresoj se para mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit, do të na vjen përgjegja nga Ministria e financave.

Kryesuesi – Uroj të jetë ashtu qysh po thua, por unë çdoherë bazohem në shkresat zyrtare të MAPL-së dhe ata kanë kërkuar me rishikue, kështu që nëse të vjen përgjegja atëherë mbetet në fuqi vendimi, por nëse nuk të vjen përgjegja ne duhet ti referohemi kërkesës së MAPL-së, për shfuqizim të vendimit.

Naim Miftari – Sqaron se janë 2 çështje të ndryshme, është kuota më e ulët dhe është subvencionimi i energjisë. Qëllimi i Ministrisë që e quan të kundërligjshme është te kuota, e jo te subvencionimi i energjisë. Nëse, ne e heqim nga Rregullorja kuotën më të ulët atëherë subvencioni i energjisë elektrike nuk paraqet problem.

Kryesuesi - Kërkoj që zyrtarisht të na njoftoni në mbledhjen e Kuvendit, se çfarë hapa duhet të ndërmarim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota "Për" morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal shqyrtimi i kërkesës së MAPL-së (rishikimi i vendimit nr I-106 dt.28.06.2019).

Pika 9 e rendit të ditës

Zarife Behluli – Pas lidhjes së kontratave të disa projekteve, ka mbetje të lira në projektet që ju me material i keni marrë që këtu, është vlera prej 176,199 €. Projekti kogjenerimi ka pasë buxhet 530,000 €, me lidhjen e kontratës kanë mbetë mjete të lira nga grandit qeveritar 111,400 €. Te furnizimi me kontejnerë buxheti ka qenë 10,000 €, ndërsa kanë mbetë të lira 775 €. Te pajisjet mjekësore në DSHMS, kanë qenë 50,000 €, nga grandit qeveritar, mbetje kemi 19,357 €. Te shtatorja “Xhavit Haziri” 120,000 €, ka pasë buxhet, ndërsa me lidhjen e kontratës mjete të lira kanë mbetë 44,667 €. Te renovimi i Palestrës sportive janë 9,183 €.

Kryesuesi – Në mungesë të rishikimit të buxhetit shuma e tillë lejohet me vendim të Kuvendit komunal deri në 15 %, e buxhetit me vendim të ministrit të financave me u ridestinue. Tash, a keni mjete tjera të lira, apo janë vetëm këto që u cekën.

Zarife Behluli – Shpresoj se në procese të tenderimit ka ende projekte të tilla që janë duke i kaluar ato faza dhe aty ku ka mbetje, unë në mbledhjen e ardhshme mund të paraqesë kërkesën në mënyrë që mjetet nga grandit qeveritar mos të shkojnë në suficit. Pra, të shfrytëzohen aty, pasi që kemi shumë projekte asfaltim të rrugëve, kubëza etj. dhe kemi marrë vendim që këto mjete, të dedikohen në asfaltim të rrugëve.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota “Për” morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së DEFZH, për transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike Investimet kapitale (IV-298, dt.20.08.2019) .

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga Agon Hashani për emërimin e rrugës në lagjen e Hashanëve me emrin “Mulla Xhemajli”.

Kjo kërkesë i dërgohet DPUKP-së, për shqyrtim dhe në mbledhjen e Kuvendit të vjen me rekomandim.

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga Behxhet Gërvalla për emërim të rrugës me emrin “Sejdi Gërvalla” në Raskovë.

Kjo kërkesë i dërgohet DPUKP-së, për shqyrtim dhe në mbledhjen e Kuvendit të vjen me rekomandim.

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga Besmir Pula për shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtime.

Kjo kërkesë i dërgohet Drejtorisë së inspeksionit dhe DPUKP-së, për shqyrtim dhe në mbledhjen e Kuvendit të vjen me rekomandim.

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga Këshilli i Bashkësisë Islame për një autoambulancë për lehtësim të punëve në terren. Poashtu, si arsye thuhet se është rritë edhe numri i vdekjeve në Komunën tonë.

Ibush Mjekiqi – Ju njoftoj se brenda një viti janë prej 100-120 vdekje. Meqenëse, me buxhetin e këtij viti ne jemi furnizue me 2 autoambulanca të reja dhe një veturë të vogël të tipit limuzinë, që kemi mundësi këtë veturë me ia dhënë bashkësisë islame me një vendim të Kuvendit dhe me një marrëveshje të nënshkruar në mes të Komunës dhe bashkësisë islame në Obiliq.

Kjo kërkesë i dërgohet Këshillit të drejtorëve dhe DSHMS-së.

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga Besa Selmani për ndihmë me mjete financiare për pajisje adekuate sportive.

Kjo kërkesë i dërgohet DKRS-së, për shqyrtim dhe në mbledhjen e Kuvendit të vjen me rekomandim.

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga Drejtoria e Arsimit, për marrjen e vendimit për rrënimin e objektit shkollor të SHFMU “Hasan Prishtina” në Raskovë, në mënyrë që të lëshohet hapësira për shkollën e re.

Fatmir Bekteshi – Unë e përkrahu këtë kërkesë sepse ajo shkollë është e vogël aty dhe ka rrezikshmëri të nxënësve.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota “Për” morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së DAK-ut (X-764-dt.27.08.2019).

Mbledhja përfundoi në ora 11:10

Bashk.prof.për punë të KK-së

Azize Zeneli



Kryesuesi i KPF-së

Burim Gërguri